

Si bëhet shpallja e kandidatit fitues?

- Njësia përgjegjëse pas marrjes së mendimit zyrtar nga kandidati/kandidatët fitues, shpall fituesin/fituesit dhe bën aktin e emërimit të kandidatit/kandidatëve.
- Shpallja e fituesit/fituesve bëhet në faqen e internetit të DAP-it dhe në portalin “AKPA”, ndërsa për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, përveç portalit, ajo bëhet edhe në standat e informimit të publikut.
- Nëpunësi civil i emëruar nuk i nënshtrohet periudhës së provës.
- Nëpunësi civil që emërohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele detyrohet të bëjë dorëzimet në pozicionin e mëparshëm të punës brenda 5 (pesë) ditëve pune.
- Nëpunësi civil detyrohet të paraqitet, pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga dita e përfundimit të dorëzimit të detyrës pranë institucionit të mëparshëm.
- Në rast të mosparaqitjes së nëpunësit civil brenda afatit të përcaktuar, të institucionit ku nëpunësi është emëruar, institucioni njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësia përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.



Na kontaktoni



04 22 68 141



Rruga “Abdi Toptani”,
ish-hotel “Drini”,
Tiranë

kms hc@kms hc.al.



PROCEDURAT E PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

(PJESA E DYTË)

LËVIZJA PARALELE

Çfarë është lëvizja paralele në shërbimin civil?

Lëvizja paralele është kalimi i nëpunësit civil në një pozicion pune të të njëjtit nivel apo klasë brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër që përfshihet në administratën qendrore apo vendore.

Çdo nëpunës civil ka mundësinë të lëvizë brenda sistemit të shërbimit civil, duke aplikuar në procedurën e plotësimit për një vend të lirë pune në kategorinë që zotëron, në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër pjesë e shërbimit civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Si realizohet procedura e lëvizjes paralele?

Procedura e lëvizjes paralele përfshin dy faza:

- Faza e parë është verifikimi i kandidatëve, të cilët përbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- Faza e dytë është vlerësimi i kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

Cilat janë kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të marrë pjesë në procedurën e lëvizjes paralele?

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.
- Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Si e vlerëson Komisioni dokumentacionin e dorëzuar nga kandidati?

Komisioni vlerëson dokumentacionin e dorëzuar sipas skemës së mëposhtme:

- Përvoja (20 pikë)
- Kualifikimi (10 pikë)
- Certifikimi/Vlerësimi i nëpunësit (10 pikë)

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është:

- 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- 60 pikë intervista me gojë

Si bëhet lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe cilat janë hapat që ndiqen?

Lëvizja paralele për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese është një procedurë disi ndryshe nga ajo e ngritjes në detyrë, sepse në të nuk përfshihet faza e testimit me shkrim.

Konkurrimi për procedurën e lëvizjes paralele përfshin dy faza:

- Verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- Vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për të kaluar procedurën e verifikimit paraprak janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vendin e lirë. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

Si ndahet struktura e pikëve të vlerësimit të kandidatit për procedurën e lëvizjes paralele?

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është si më poshtë vijon:

- 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.
- 60 pikë intervista me gojë.